

Terma reference

Thirrje për ekspert për përgatitjen e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë

Konsulenca	Përgatitja e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë
Projekti	Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar për grupet vulnerabël si pasojë e vështirësive të shkaktuar nga emergjencat civile në Bashkinë Krujë
Zonat e projektit	Bashkia Krujë
Kohëzgjatja e projektit	Gusht 2021 – Korrik 2022
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	29 Janar 2022

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë një ekspert për **përgatitjen e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë** si pjesë e projektit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar për grupet vulnerabël si pasojë e vështirësive të shkaktuar nga emergjencat civile në Bashkinë Krujë” zbatuar nga Nisma ARSIS me mbështetjen e PNUD në Shqipëri në lidhje me programin “Forcimi i Reagimit të Mbrojtjes Sociale pas Tërmetit në Shqipëri”.

Rreth Nisma ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Rreth projektit

Kjo nismë zbatohet në kuadër të projektit “Masat reaguese të mbrojtjes sociale pas tërmetit”, i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe i financuar nga Fondi i Përbashkët SDG dhe Fondi për Rimëkëmbjen e Tërmeteve. Projekti mbështet Qeverinë Shqiptare dhe tre bashki të prekura nga tërmeti, në hartimin dhe përkthimin e synimit të politikave në veprimet e duhura vendore për të siguruar që burrat, gratë, vajzat dhe djemtë që jetojnë në varfëri ose situata të cënueshme, që kryqëzohen me kushtet pas tërmetit, të kenë akses ndaj shërbimeve të integruara dhe cilësore sociale.

Projekti do të mbështesë Bashkinë Krujë, si një zonë e prekur nga tërmeti nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale cilësore dhe të integruara për fëmijë, nëna, dhe prindër që jetojnë në varfëri apo në situatë vulnerabël.

Për të arritur këtë qëllim projekti është fokusuar në ngritjen e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) në nivel Bashkie me rol specifik në trajtimin e grupeve vulnerabël dhe në nevojë për shërbime shoqërore, zhvillimin e detajuar të vlerësimit të nevojave në komunitetet e prekura nga tërmeti dhe njëkohësisht edhe nga pasojat e pandemisë COVID-19 si dhe ofrimin e shërbimeve direkte shoqërore për tejkalimin e pasojave dhe vështirësive të krijuara nga tërmeti dhe COVID-19. Struktura Përgjegjëse për Shërbimet Shoqërore në kuadër të këtij projekti do të realizojë edhe hartimin e një plani veprimi lokal për përgjigjen ndaj emergjencave civile duke përfshirë dhe planifikimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen e fëmijëve në situatë emergjence.

Hartimi i Planit të Veprimit për realizimin e ndërhyrjeve dhe ofrimin e shërbimeve sociale në situatë të emergjencave civile synon të ndihmojë vendimmarrësit në nivel lokal, të cilët gjithnjë e më shpesh u duhet të menaxhojnë fatkeqësitë, qofshin ato natyrore apo të bëra nga njeriu, dhe ri-drejtimin e menjëhershëm të procesit të rimëkëmbjes. Nëpërmjet një eksperti të jashtëm, do të mundësohet kategorizimi i të gjitha nevojave të identifikuara si dhe mënyrat e adresimit të tyre në një metodologji praktike, e cila do të formalizojë mënyrat efektive, praktikat pozitive dhe ndërhyrjet konkrete në përgjigjen imediate ndaj emergjencave të cilat afektojnë më tepër grupet vulnerabël njëkohësisht duke përfshirë dhe mbrojtjen e fëmijëve në kushtet e emergjencave. Planit i veprimit dhe ndërhyrjes do të shërbejë të gjitha palëve të interesuara që luajnë rol në zbatimin e tij, me qëllim zvogëlimin e rreziqeve dhe qëndrueshmërinë e përpjekjeve për rimëkëmbje.

Grupet përfituese dhe aktorët kyç:

- Fëmijë dhe familjet e tyre në situatë vulnerabël;
- Fëmijë dhe të rritur në situatë të lartë rreziku dhe në nevojë për mbështetje;
- Fëmijë dhe familjet e tyre të prekura nga tërmeti i Nëntor 2019;
- Punonjës të strukturave vendore si drejtoria e shërbimit social (NJMF, NJVNR, Koordinatorin i dhunës, etj).

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në vijim të punës së vazhdueshme dhe përpjekjeve të përbashkëta për fuqizimin e sistemit të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale dhe përgjigjes së menjëhershme për të adresuar çështjet që lidhen me kategoritë vulnerabël dhe mbrojtjen e fëmijëve synohet të përforcohet në vazhdimësi qasja koordinuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje ashtu si dhe planifikimin e ndërhyrjeve në të ardhmen në rast emergjencash nëpërmjet një plani të përbashkët veprimi në raste emergjencash për mbrojtjen e fëmijëve, udhëhequr nga ASHDMF.

Planit të Veprimit për realizimin e ndërhyrjeve dhe ofrimin e shërbimeve sociale në situatë të emergjencave civile duhet të konsiderojë emergjencat e shkaktuara nga: fatkeqësitë natyrore (zjarret, tërmetet dhe përmytjet), emergjencat shëndetësore si pandemitë; dhe situata humanitare të krijuara nga ardhja dhe/ose kalimi i refugjatëve dhe migrantëve. Ky plan duhet të ketë në vëmendje dhe rreziqet e mbrojtjes së fëmijëve me të cilat fëmijët mund të përballen gjatë emergjencave dhe interesin më të lartë të fëmijëve në çdo rrethanë. Draftimi i planit të veprimit për realizimin e ndërhyrjeve në ofrimin e shërbimeve sociale në kushtet e emergjencave (përfshirë dhe mbrojtjen e fëmijëve) duhet të përfshijë hartimin e listës së shërbim ofruesve të disponueshëm me programe mbështetëse për kategoritë vulnerabël (gra, fëmijë), fushat ku organizatat janë specializuara, zonat gjeografike që mund të mbulohen, institucionet kyç për zbatimin e planit, burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare në varësi të llojit të emergjencës, etj.

Ky plan do të jetë një dokument i hartuar nga eksperti dhe i konsultuar me strukturat shërdhe i udhëhequr nga Bashkia Krujë.

Detyrat:

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

- Përgatitjen e një plani paraprak pune me afate të përcaktuara të të gjitha fazave të hartimit të planit të veprimit;
- Inicimin e takimeve në lidhje me përgatitjen e planit dhe përcaktojë datat kur nevojitet inputi i tyre;
- Rishikimin e literaturës dhe gjithë dokumentacionit përkatës që lidhet me hartimin e planit, duke marrë në konsideratë gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës;
- Dizenjimin e Planit të Veprimit, të ndarë sipas tipologjisë së emergjencës dhe nevojave specifike që lindin për garantimin e mbrojtjes së fëmijëve në hartimin e një procedurekonkrete që duhet organizuar dhe zbatuar nga institucionet dhe partnerët për të aktivizuar mbrojtjen sociale gjatë përgjigjes ndaj emergjencave të shkaktuara;
- Mbledhjen dhe Reflektimin e të gjitha komenteve që vijnë nga grupet konsultuese;
- Mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe konsultimi me Bashkinë Krujë dhe NISMA ARSIS;
- Përgatitjen e dokumentit final;
- *Njohjen dhe zbatimin me profesionalizëm të dokumentacionit të punës së organizatës NISMA ARSIS (rregulloren e brendshme, politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, kodin e sjelljes, konventën e të drejtave të fëmijëve dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë djeni).*

Eksperti duhet të dorëzojë:

- a) Metodologjinë dhe kalendarin e aktiviteteve të nevojshme për draftimin e planit;
- b) Draftin e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël duke përfshirë dhe përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë;
- c) Realizimin e takimeve konsultuese me grupin e punës për emergjencat.
- d) Dokumentin final për hartimin e Planit të Veprimit;

Afatet kohore

Aktivitete	Afati
Dorëzim i draftit të parë të strukturës së Metodologjisë përfshirë dhe planin e aktiviteteve	31 janar 2022
Dorëzimin e metodologjisë finale	8 shkurt 2022

Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare e ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale;
- Njohuri shumë të mira rreth situatës së grupeve vulnerabël dhe në nevojë të prekur nga emergjencat;
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 dhe të gjithë paketës ligjore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore;

- Më tepër se 5 vite eksperiencë profesionale si ekspert dhe praktikë në sistemin e mbrojtjes sociale, shërbimeve sociale, të mbrojtjes së fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve në situatë vulnerabël;
- Trajnime dhe eksperiencia të mëparshme në vlerësimin e nevojave të komunitetit në nivel lokal dhe kombëtar;
- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve dhe analizave në fushën e mbrojtjes sociale.
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren;
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e NISMA ARSIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Aftësi të mira në përdorimin e paketës MS Office

Politikat e Mbrojtjes: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Kohëzgjatja e kontratës së shërbimit është 6 (gjashtë) ditë pune dhe data e mundshme e fillimit të punës është 15 Janar 2022.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi,
- 2- Curriculum Vitae (shoqëruar më evidencë të punëve të mëparshme të ngjashme).
- 3- Oferta financiare
- 4- Deklarata e disponueshmërisë

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **24 janar 2022**, mesnatë, me subjekt: Aplikimi për “**Ekspert për përgatitjen e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë**”

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistimit për pozicionin e ekspertit do të kontaktohen.